



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1200/5 Prot.

Durrës, më 28/04 2025

VENDIM

Nr. 49, datë 28/04 2025

"Miratimi i pagesës së orëve mësimore të realizuara mbi mësimdhënien e normuar vjetore për personelin akademik me kohë të plotë i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës

Bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 11.06.2009, "Për trajtimin me pagë të personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 29 datë 09.10.2018, të ndryshuar, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë", vendimin e Rektoratit nr. 2, datë 15.01.2025, shkresën e administratorit nr.1113prot., date 25.04.2025, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e pagesës së orëve të realizuara në masën deri në 200 orë mësimore të lejueshme mbi normën mësimore vjetore brenda auditorit, për personelin akademik me kohë të plotë, për pesë fakultetet e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës sipas Udhëzimit nr. 29 datë 09.10.2018, të ndryshuar, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë".
2. Miratimin e pagesës mbi limitin 200 orë mësimore deri në 300 orë mësimore, si orë mësimore suplementare të realizuara brenda auditorit, për personelin akademik me kohë të plotë për pesë fakultetet e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, vetëm në rastet specifike pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues, propozimit të drejtuesit të Njesisë bazë dhe miratimit nga drejtuesi i Njesisë kryesore.
3. Pagesat të kryhen periodikisht në baza mujore, semestrale ose vjetore sipas evidencave/formularëve të dorëzuara për çdo pedagog mbi realizimin e orëve përkatëse shtesë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Drejtoria e Adminsitrimt Financiar
 - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

